



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202101395/8

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandim për respektimin e afateve ligjore në nxjerrjen e akteve për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim*

**GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Tiranë

**GJYKATËS SË POSAÇME TË APELIT KUNDËR KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Tiranë

**PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE
KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Tiranë

Për dijeni: **MINISTRISË SË DREJTËSISË**
Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

Të nderuar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetësja L.E., bashkëshortja e të dënuarit me burgim A. E., e cila ngre shqetësimin se

periudha e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë e deri në datën kur ai është ekzekutuar, gjithsej 51 ditë, nuk është llogaritur si kohë e vuajtës së dënimit në urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal të nxjerrë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Për verifikimin e kësaj ankese jemi interesuar fillimisht në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila në përgjigjen¹ që na ka kthyer shprehet se:

Përlllogaritja e afatit të vuajtur nga i dënuari A. E. është bërë konform neneve 237, 238, 263, 463, 464 dhe 465 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me nenin 57 të Kodit Penal, si dhe në zbatim të nenit 21 të Ligjit Nr.79, datë 25.06.2020 “*Për ekzekutimin e vendimeve penale*”. Në përlllogaritjen e afatit të kohës së vuajtjes së dënimit është llogaritur koha e qëndrimit me masën e sigurimit “arrest në burg”, nga data 02.02.2019 deri në datën 22.04.2020, si dhe koha e qëndrimit “Arrest në shtëpi”, nga data 22.04.2020 deri sa vendimi ka marrë formë të prerë më datë 06.07.2021.

Në lidhje me pretendimet e ankueses për përlllogaritjen e ditëve të tjera tej periudhës që vendimi ka marrë formë të prerë, datë 06.07.2021, këto pretendime nuk mbështeten në ligj si dhe në praktikat ligjore të Gjykatës së Lartë në lidhje me ekzekutimin e vendimit të formës së prerë, si Vendimi Nr.2, datë 03.11.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Vendimi Nr.187, datë 06.07.2000 i Kolegjit Penal.

Bashkëlidhur përgjigjes së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar na është dërguar praktika e ekzekutimit të vendimit penal në ngarkim të shtetasit A. E., nga e cila rezulton si vijon:

¹ Shkresa Nr.9036/1 Prot/ (VM&D.P), datë 23.11.2021.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me Vendimin Nr.16, datë 09.02.2021 ka vendosur dënimin e shtetasit A. E. me 3 vite e 4 muaj burgim për veprën penale “*Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufijve*”, të parashikuar nga neni 298/2 të Kodit Penal dhe neni 406 të Kodit të Procedurës Penale .

Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me Vendimin Nr.19, datë 06.07.2021 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të lartpërmendur.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën Nr. 16 Prot., datë 26.07.2021, u ka dërguar dy prokurorëve të çështjes, fotokopje të shkurtimit të Vendimit nr.19, datë 06.07.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Në vijim, në datën 20.08.2021, prokurorët e çështjes kanë nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë, nr.16, datë 09.02.2021 (në përgjigjen që kemi marrë nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar thuhet se ky urdhër është nxjerrë pasi është siguruar vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar). Sipas këtij urdhri, i dënuari A. E. duhet të vuajë dënimin e mbetur pas datës 06.07.2021, datë kur vendimi ka marrë formë të prerë, prej 3 (tre) muaj e 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë burgim, në një burg të sigurisë së zakonshme.

Urdhri i ekzekutimit të vendimit penal i është dërguar për zbatim Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë me shkresën Nr.73 Prot/Q.Sh, datë 26.08.2021. Gjithashtu ky

urdhër i është dërguar për dijëni edhe të dënuarit A. E. me shkresën Nr.160/11 Prot/Q.Sh, datë 26.08.2021, në adresën e tij të banimit, ku ai ishte ndërkohë duke qëndruar, me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”.

Hetimi ynë administrativ ka vijuar duke kërkuar informacion pranë Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe IEVP Fier lidhur me datën kur është zbatuar urdhri i ekzekutimit të vendimit penal dhe datën kur është liruar nga burgu ky shtetas. Në përgjigjet² që kemi marrë vihemi në dijëni se shtetasi A. E. është marrë nga punonjësit e policisë në banesën e tij në datën 27.08.2021 dhe është dërguar në IEVP Fier në datën 01.09.2021. Ndërsa dënimi me burgim për këtë shtetas ka përfunduar në datën 14.12.2021.

Gjatë qëndrimit në IEVP Fier, shtetasi A. E. i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me kërkesë për të njohur si kohë të vuajtjes së dënimit, periudhën e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë e deri në datën kur ai është ekzekutuar, por kjo kërkesë e tij nuk është pranuar. Në bisedën telefonike që kemi pasur me ankuesin (pas përfundimit të vuajtjes së dënimit), banues në Konispol, ai është shprehur se nuk e ka apeluar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sepse do të lirohej nga burgu ndërkohë që çështja do të shqyrtohej në shkallë të dytë dhe nuk kishte mundësi ekonomike për të përballuar shpenzimet për ta ndjekur çështjen në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me Vendimin Nr. 62-2021-5498 (1498), datë 11.11.2021 është shprehur se kërkesa e të dënuarit A. E. është e pabazuar në ligj dhe duhet të vendoset mospranimi me arsyetimin e përmbledhur si vijon:

² Shkresat Nr.3949/1 Prot., datë 21.12.2021 e Komisarariatit të Policisë Sarandë dhe Nr.5383/1 Prot., datë 24.12.2021 e Institucionit të Ekzekutimit të vendimeve Penale Fier.

“Me marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor penal të dënimit, nuk mund të flitet për ekzistencë të fuqisë juridike të masave të sigurimit. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” humbet fuqinë me marrjen formë të prerë të vendimit penal. Pas këtij momenti, e gjithë procedura e ekzekutimit është përgjegjësi e koordinimit midis Gjykatës, e cila ia përcjell vendimin Prokurorit të ekzekutimit në Prokurorinë pranë saj, dhe më tej prokurori nxjerr urdhrin e ekzekutimit. E gjithë hapësira kohore e nevojshme e koordinimit të këtyre institucioneve nuk mund të interpretohet se i dënuari vijon të jetë me masë sigurimi, pasi masat e sigurimit i shërbejnë garantimit të hetimeve dhe gjykimit, ndërsa në situatën konkrete si faza e hetimit dhe ajo e gjykimit të një vendimi është ezauruar, dhe masat e sigurimit nuk mund të përdoren për të garantuar fazën e ekzekutimit të një vendimi penal. Faza e ekzekutimit garantohet nga vetë strukturat, procedurat dhe veprimtaria konkrete e përcaktuar shprehimisht në ligjin e posaçëm, ku parashikohet ekzekutimi vullnetar e më tej ai i detyrueshëm. Mund të ndodhë që organet kompetente të mos koordinohen për një periudhë relativisht të gjatë midis tyre për të ekzekutuar vendimin penal, pra prokurori të vonojë në nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit. Kjo nuk do të thotë që shtetasi i dënuar të vijojë të jetë me masë sigurimi “arrest në shtëpi”. Pretendimi i kërkuarit se ai ka qenë duke qëndruar në shtëpi nga data 06.07.2021 deri në datën 27.08.2021 nuk është i bazuar, pasi kërkuari nuk e ka pasur këtë detyrim. Dënimi i tij penal me burgim ka marrë formë të prerë me dhënien e vendimit nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr.19, datë 06.07.2021 dhe në atë datë është bërë i ekzekutueshëm vendimi penal me burgim ndaj tij. Fakti që nuk ka pasur një koordinim të shpejtë midis organeve kompetente për ekzekutimin e dënimit me burgim, nuk do të thotë që ka vijuar të jetë në fuqi masa e sigurimit “arrest në shtëpi” ndaj tij. Mosdija e ligjit, qoftë edhe atij procedural nuk përbën shkak për t’i dhënë ligjit një interpretim të ndryshëm nga ai që ka pasur për qëllim ligjvënësi”.

Pra, referuar arsytimit të organit të gjykatës në lidhje me këtë çështje, shtetasi A. E. mund të lëvizte i lirë pasi vendimi ka marrë formë të prerë, në pritje të ekzekutimit të tij, sepse masa e sigurisë “Arrest në shtëpi” e kishte humbur fuqinë. Këtu gjykata ka anashkaluar një pjesë të arsyes së caktimit të masës së sigurimit personal, të cilën vetë e shpjegon në analizën për rastin. Më konkretisht citojmë: *“Gjykata arsyeton se referuar edhe qëndrimeve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, një nga arsyet e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal është nevoja për të garantuar vijimësisht prezencën e të gjykuarit në procedimin penal në ngarkim të tij, si për të siguruar normalitetin e hetimit dhe të gjykimit në çështjen në ngarkim të tij, nevojën për të evituar rrezikun për kryerjen e veprave të tjera penale prej tij, ashtu **edhe për të siguruar që ai të mos largohet, të fshihet, por t’i nënshtrohet ekzekutimit (vuajtjes) së dënimit kur vendimi i dënimit të ketë marrë formë të prerë**”*. Nuk mund të mos pranojmë se, nëse shtetasi A. E. do të vepronte sipas arsytimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, pra të lëvizte i lirë pasi vendimi³ të kishte marrë formë të prerë, në pritje të ekzekutimit të tij, ai mund të rrezikonte procedimin penal për veprën *“Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”* (neni 323 i Kodit Penal) dhe një trup tjetër gjykues mund të jepte një interpretim ndryshe të rastit. Për të gjitha këto, qytetari i çfarëdolloj arsimimi, shtrese sociale apo formimi profesional duhet të hamendësojë me saktësi që të mos penalizohet, pasi: *“Mosdija e ligjit, qoftë edhe atij procedural nuk përbën shkak për t’i dhënë ligjit një interpretim të ndryshëm nga ai që ka pasur për qëllim ligjvënësi dhe që praktika i ka dhënë jetë, pra masat e sigurimit shuhen ipso iure me marrjen e formës së prerë të vendimit”* (citim nga përmbajtja e vendimit).

Nga ana tjetër duhet të evidentojmë që mungesa e koordinimit të shpejtë midis organeve kompetente për ekzekutimin e dënimit me burgim, pra nxjerrja me vonesë e urdhrin të ekzekutimit, ka sjellë pasoja për shtetasin A.

³ Vendimi Nr.19, datë 06.07.2021 i Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

E., pasi ai në pritje të vendimit ka vijuar të qëndrojë në shtëpi në zbatim të masës së sigurimit “Arrest në shtëpi”.

Nga ana jonë u analizua në tërësi legjislacioni që ka të bëjë me ekzekutimin e një vendimi penal (Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”) si dhe dy vendimet e referuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, konkretisht Vendimi Nr.2, datë 03.11.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë si dhe Vendimi Nr.187, datë 06.07.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Ligji Nr.79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” përcakton subjektet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimit penal dhe afatet e veprimeve që këto subjekte duhet të kryejnë. Më konkretisht, në nenin 23, pika 1 përcaktohet si më poshtë vijon:

“Vendimet me burgim, me marrjen formë të prerë, i dërgohen prokurorit nga gjykata sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj”.

Ndërsa, afatet e veprimeve të gjykatës, përcaktohen në nenin 63 të këtij ligji, ku parashikohet se:

“1. Veprimet për vënien në ekzekutim të vendimit penal kryhen menjëherë sapo të jenë plotësuar kushtet ligjore, por jo më vonë se brenda këtyre afateve:

- a) për vendimet që përmbajnë dënim me burgim dhe për të cilat nuk është ushtruar ankim, gjykata i dërgon prokurorit kopjen e vendimit të përmbledhur brenda 24 orëve nga e nesërmja e ditës që vendimi merr formë të prerë;*

b) *vendimet e përmbledhura, që përmbajnë dënime të tjera penale ose urdhërime të tjera, i dërgohen prokurorit nga gjykata jo më vonë se 3 ditë nga marrja formë të prerë”.*

Në këtë nen nuk përcaktohet afat për rastet, kur vendimi ka marrë formë të prerë pasi është ankimuar nga palët. Megjithatë çmojmë se afati i parashikuar në shkronjën “a” duhet të zbatohet edhe për këto raste, për sa kemi të bëjmë me dënim me burgim.

Sipas detyrimit ligjor, prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë, pas administrimit të vendimit përmbledhës për dënimet me burgim, duhet të kryejë veprimet paraprake për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit (neni 64, shkronja “a” i Ligjit Nr.79/2020 parashikon se: “Prokurori kryen veprimet paraprake dhe nxjerr urdhrin e ekzekutimit: a) për dënimet me burgim ose mjekim të detyrueshëm në institucionet mjekësore, me të paraburgosur, menjëherë pas marrjes së përmbledhjes së vendimit”).

Nga praktika e ekzekutimit të vendimit penal të rastit në fjalë, konstatojmë se shkurtimi i vendimit të formës së prerë në ngarkim të shtetasit A. E., u është dërguar prokurorëve të çështjes nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, 20 ditë pasi është shpallur. Urdhri i ekzekutimit të vendimit penal është nxjerrë 25 ditë pasi shkurtimi i vendimit të formës së prerë i është dërguar prokurorisë dhe 6 ditë nga ky veprim i prokurorit, urdhri i është dërguar për zbatim organit vendor të Policisë së Shtetit. Pra, e gjithë procedura e ekzekutimit të vendimit penal me burgim ka zgjatur tej afateve ligjore (51 ditë) dhe në vlerësimin tonë edhe tej një afati të arsyeshëm duke patur parasysh ngarkesën që mund të kenë organet e drejtësisë apo situatën e krijuar nga pandemia e virusit Covid-19.

Një çështje që kërkon vëmendje për t'u trajtuar lidhet me faktin se nga organi i prokurorisë nuk është llogaritur si kohë e vuajtjes së dënimit, periudha e qëndrimit të të dënuarit me masë të sigurimit “Arrest në shtëpi” nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë e deri në datën kur është ekzekutuar vendimi.

Megjithëse Gjykata e Shkallës së Parë Fier është shprehur për këtë çështje, parashtrojmë se sipas Kodit të Procedurës Penale, në Seksionin II, Masat Shtrënguese, nenin 237 të tij “Arrestin në shtëpi”, parashikohet si më poshtë vijon:

“1. Me vendimin e arrestit në shtëpi, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij ose nga një vend i caktuar ku ai banon, kurohet ose mbahet me asistencë.

2. Kur cakton këtë masë, gjykata përcakton edhe mënyrën e ekzekutimit dhe të mbikëqyrjes së saj.

3. Prokurori dhe policia gjyqësore kontrollojnë respektimin e urdhrave që i janë dhënë të pandehurit.

4. Për kohëzgjatjen e arrestit në shtëpi vlejné rregullat e caktuara për paraburgimin.

5. Koha e qëndrimit në arrest në shtëpi llogaritet në caktimin e dënimit.

Pra, pika 5 e kësaj dispozite përcakton se koha e qëndrimit në arrest në shtëpi llogaritet në caktimin e dënimit. Masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” është një masë kufizuese e të drejtës së një personi për të lëvizur lirisht dhe pavarësisht se i pandehuri ndodhet në kushte shtëpiake, është çmuar se kjo periudhë duhet të llogaritet si kohë e vuajtjes së dënimit. Evidentojmë se, vendimet e Gjykatës së Lartë të referuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ku ky organ mbështet qëndrimin e vet, për të mospranuar pretendimin e ankuesit A. E., nuk kanë në përmbajtje të tyre arsyetime lidhur me çështjen. Pra, kjo praktikë gjyqësore nuk lidhet me rastin, objekt të hetimit tonë administrativ.

Vendimi Nr.2, datë 03.11.2014 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka objekt të trajtimit të tij, përcaktimin se cili është momenti që një vendim gjyqësor penal quhet apo konsiderohet i formës së prerë, nisur nga fakti se ka interpretime jo të njëjta, duke dhënë edhe kuptimin e terminologjisë “vendim i ekzekutueshëm”, “vendim i formës së prerë” dhe “gjë e gjykuar”.

Ndërsa Vendimi Nr.187, datë 06.07.2000 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka trajtuar zgjatjen e afatit, gjatë hetimeve paraprake. Sipas vlerësimit të Kolegjit Penal afatet e paraburgimit janë parashikuar si garanci për mbrojtjen e të drejtave procedurale të të pandehurit të cilat e detyrojnë organin procedues sipas rastit, të përfundojë hetimin ose gjykimin e çështjes në një kohë të arsyeshme, por kurdoherë jo më vonë se maksimumi i kohës së parashikuar në ligj. Nëse kanë mbaruar të gjitha afatet e parashikuara dhe pavarësisht nga vepra për të cilën i pandehur akuzohet, qëndrimi i tij në paraburgim është i kundërligjshëm. (Të dyja vendimet janë të një natyre të ndryshme nga rasti që kemi trajtuar në hetimin tone administrativ.)

Meqenëse Gjykata e Shkallës së Parë Fier ka arsyetuar dhe ka vendosur se, periudha e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” për kërkuesin A. E., nga data kur vendimi ka marrë formë të prerë e deri në datën kur ai është ekzekutuar, nuk llogaritet si kohë e vuajtjes së dënimit, sepse masa e sigurimit e ka humbur fuqinë, dhe ky qëndrim nuk është ankimuar nga palët, atëherë organi i prokurorisë dhe Policia e Shtetit duhet të pranojnë se i dënuari me burgim mund të lëvizë i lirë në këto raste, derisa vendimi të ekzekutohet, edhe nëse procedura e ekzekutimit zgjat disa ditë, duke marrë parasysh edhe rrezikun e largimit të të dënuarit.

Në zbatim të neneve 74, 75, 76 dhe 77 të Ligjit Nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe VKM Nr.434, datë 15.07.2021 “Për përcaktimin e

kritereve për zgjedhjen e anëtarëve, si dhe të rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, pranë Ministrisë së Drejtësisë është ngritur pak kohë më parë Komisioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, i përbërë me 9 anëtarë të caktuar nga disa institucione. Një ndër kompetencat e këtij Komisioni është kryerja e verifikimeve në institucionet e dënimit mbi bazën e ankesave ose njoftimeve të paraqitura, marrja e takimit në çdo kohë me të burgosur të veçantë, kërkimi i sqarime, këqyrja e dokumenteve dhe mjediseve si dhe bërja e verifikimeve të tjera të nevojshme. Në vlerësimin tonë, funksionimi me efikasitet i këtij organi do të ishte me vlerë në zbatimin me përpikmëri të ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale dhe garantuar të drejtat e të dënuarve.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*".

REKOMANDOJMË:

- Analizimin e këtij rasti lidhur me qëndrimin që do të mbahet ndaj shtetasve me masë sigurimi personal “Arrest në shtëpi”, të cilët janë në pritje të ekzekutimit të vendimit të gjykatës si dhe llogaritjen e kësaj

periudhe kohore (për raste të tjera të ngjashme) në caktimin e dënimit që nga çasti kur vendimi ka marrë formë të prerë.

- Marrjen e masave të nevojshme për respektimin e afateve ligjore për nxjerrjen e akteve për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim, dërgimin në institucionet përkatëse dhe ekzekutimin e tyre në funksion të garantimit dhe moscënimit të të drejtave të shtetasve të dënuar.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca